39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 623-24-493-5-2-1/C555

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: 37 Muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 15 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbikëqyrës. AFATI I IMPLEMETIMIT të këtij projekti është: 36 muaj, nga data e fillimit të punëve
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve të përgjithshme të kontratës. Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga Zyratari Kryesor Administrativ (ZKA)

Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % të vlerës së kontratës Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi me kërkesë mund të zëvendësoj paratë të mbajtura me Polisë të sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Kompani e Sigurimeve apo Bankë e Licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës, prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës me afat validiteti prej: 36 muaj, nga data e lëshimit të certifikatës për pranimit të përkohshëm të punimeve.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është: 36 muaj . Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është: përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Aneksi - 6.1

AFATI I PERIUDHËS GARANTUESE

Për: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: **N.N."INGINERIN MSH" dhe „TOSI-V,, SH.P.K**
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE, MARTIRËVE DHE CIVILËVE**

Numri i Prokurimit: **623-24-493-5-2-1**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriteri i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE dhe AFATIN E IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT, DEKLAROJMË se do të përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I.PERIUDHA GARANTUESE vlen 3 vite vite nga data e pranimit të përkohshëm të projektit

Shëno numrin e viteve

nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

Milazim Shala

Emri i përfaqësuesit të OE




Nënshkrimi



PARAMASA DHE PARALLOGRIA PËR NDËRTIMIN VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE MARTIRËVE NË RAHOVEC

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

A	VARREZAT DËSHMORËVE DHE MARTIRËVE NË RAHOVEC				
1	VARREZAT E DËSHMORËVE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Furnizimi,transporti dhe punimi i murit nga B.A me lartësi h=1m gjërsi 25cm dhe gjatësi 6m, me shputë nga B.A ,me dimensione 0.4x06m. Në çmim të llogaritet edhe pjesa e armimit.	m³	3.00	300.00 €	900.00
1.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i varrezave të Dëshmorëve. Punimi i shabllonit me beton C=20/25, në pjesën e bazamentit të varrezave,dhe pjesët ansore, hapësira e brëndshme duhet mbushur me zhavor dhe të përgatitet për vendosjen e pllakave të granitit.	m³	25	85.00	2,125.00
1.3	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit në pjesët anësore me trashësi t=2cm. Në çmim të llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). <i>(Vërejtje ngjyrate granitit duhet të jetë e njëjt me varrezat ekzistuese)</i> .	m²	63	55.00	3,465.00
1.4	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit për varreza me trashësi t=3cm. Pjesa e sipërme e varrit duhet të jetë komplet e mbuluar me granit dhe pjesët ansore duhet të jetë 3cm jashtë granitit anësor. Në çmim të llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). <i>(Vërejtje ngjyra e granitit duhet të jetë e njëjt me varrezat ekzistuese)</i> .	m²	55	200.00	11,000.00
1.5	Furnizimi ,transporti dhe montimi i pllakave te granit me trashësi t=3cm me dimensione 80x60cm e vendosur te koka e varrit e përforcuar në pllaken e poshtme të granitit. Ne pllakë duhet të bëhet gravimi i emrit, mbiemrit, viti i lindjes viti i rënjes dhe emblema e UÇK-së, brenda hapësirave të gravimi duhet të ngjyroset me ngjyrë të arit. Në çmim të llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).	m²	8	200.00	1,600.00
1.6	Furnizimi, transporti ndërtimi dhe riparimi i pllakave të mermerit në ato pjesë të cilat janë të dëmtuar në komplet sipërfaqen murit ekzistues. Pllakat e mermerit te zëvendësohen me pllaka të ngjajshme ekzistuese. Në çmim të llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).	m²	20	100.00	2,000.00
1.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës metalike te varrezat e dëshmorëve. Me dimensione 1.2x 1.4m Në çmim të llogaritet vendosja e mekanizëm për hapje dhe mbyllje.	copë	1	700.00	700.00
1.8	Furnizimi , transporti dhe montimi i rrethojës me profile metalike e ngjajshme me atë ekzistuese, me lartësi h=1.2m. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë të zezë.	m'	6.00	130.00	780.00
1.9	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse.Me profile met' 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anët nga konstruksioni metalik. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Ulësja të punohet sipas detalit të prezantuar.	copë	2	300.00	600.00



[Handwritten signature]



1.10	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Panja (Acer platanoides "Globosum"), me kurorë mirë të formuar, 250 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjillore ose ranore-argjillore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Operatori është i obliguar që të kujdeset për druideri në kultivim, në raste deshtonë duhet të zëvendësoj atë me të ri.	copë	5.00	40.00 €	200.00
TOTALI 1:				23,370.00	
2	VARREZAT E MARTIRËVE				
2.1	Demolimi i varrezave nga pllakat e granitit, mermerit, xokullës nga B.A. Transporti, sipas kërkesës së familjarve ose vendin ku e cakton autoriteti kontraktues në deponi deri në largësi max deri 10km.	copë	38.0	10.00 €	380.00
2.2	Demolimi i kubëzave ekzistuese. Demolimi të realizohet deri në sipërfaqen e dheut. Transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton autoriteti kontraktues, largësi max deri 10km	m²	147.0	2.00 €	294.00
2.3	Pastrimi i parcelles nga mbeturinat e mundshme dhe demolimin e shkurreve. Transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton organi mbikqyres, largësi max deri 5km	copë	1.0	50.00 €	50.00
2.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i murit nga B.A me lartësi h=1.5m gjërsi 25cm dhe gjatësi 2m, me shputë nga B.A ,me dimensione 0.4x0.6m. Në çmim të llogaritet pjesa e armimit, mveshja me mermer pjesa ballore, e sipërme dhe pjesët anore, dhe vendosja e hekurave për vendosjen e lulëve.	m³	3.00	250.00 €	750.00
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i varrezave të Martirëve. Punimi i shabllonit me beton C=20/25, në pjesën e bazamentit të varrezave, dhe pjesët anore, hapësira e brëndshme duhet mbushur me zhavor dhe të përgatitet për vendosjen e pllakave të granitit.	m³	57.00	85.00 €	4,845.00
2.6	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit në pjesët anësore me trashësi t=2cm. Në çmim të llogaritët edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). (Vërejtje ngjyra e granitit duhet të jetë e njëjtë me varrezat ekzistuese).	m²	258.00	55.00	14,190.00
2.7	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit për varreza me trashësi t=3cm. Pjesa e sipërme e varrit duhet të jetë komplet e mbuluar me granit dhe pjesët anore duhet të jetë 3cm jashtë granitit anësor. Në çmim të llogaritët edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C). (Vërejtje ngjyra e granitit duhet të jetë e njëjtë me varrezat ekzistuese).	m²	167.00	85.00 €	14,195.00
2.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave të granit me trashësi t=3cm me dimensione 80x60cm e vendosur te koka e varrit e përforcuar në pllaken e poshtme të granitit. Në pllakë duhet të bëhet gravimi i emrit, mbiemrit, viti i lindjes dhe viti i rënjes, brenda hapësirave të gravimi duhet të ngjyrosët me ngjyrë të arit Në çmim të llogaritët edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).	m²	35.00	180.00 €	6,300.00
2.9	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse. Me profile metali 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anët nga konstruksioni metalik. Në çmim të llogaritët edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Ulësja të punohet sipas detalit të prezantuar.	copë	2	250.00	500.00
2.10	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës metalike të varrezat e martirëve, nga profilet metalike me dim. 140.120cm. Me mekanizëm për hapje dhe mbyllje. Në çmim të llogaritët edhe lmyerja me bazë dhe ngjyrë të zezë.		1	350.00	350.00

2.11	Gërmimi i dheut të kategorisë III -IV me trashësi t=30cm për përgatitjen e bazës së kubzave Transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m³	34.00	5.00 €	170.00
2.12	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur.	m³	33.00	8.00 €	264.00
2.13	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm²	m³	16.00	8.00 €	128.00
2.14	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubëzave të cilat realizohen në hapësirat ku do të ndërtohet shtigjet e ecjes Me dimensione 40x20 me trashësi t=6cm, Ngjyrë bardhë dhe zi e ndërthtur. Në çmim të kalkulohet shtresa e rërës fraksion 4 mm me trashësi t=6 cm dhe mbushja e fugave të kubëzave me rërë të imët.	m²	168.00	25.00 €	4,200.00
2.15	Furnizimi dhe montimi i skajoreve 8x20x100 cm në çmim të kalkulohet edhe betoni për shtangim në skajor dhe mes fugave.	m¹	380.00	9.00 €	3,420.00
2.16	Furnizimi transporti dhe montimi i shtizës metalike h=6m rrethore me dimensione D=141.3x5mm,, Shtyllat të inkastrohen me anë të bulonave M22mm me flanks 40x40cm dhe trashësi 5mm,e cila vendoset në bazament prej betoni me dimensione 08x0.8x0.8m Në çmim të llogaritet edhe mekanizmi për ngritjen e flamurit, ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid dhe vendosja e flamurit me dimensione 1x2m.	copë	2.00	250.00 €	500.00
2.18	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-Panja (Acer platanoides "Globosum"), me kurorë mirë të formuar, 250 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm,sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i certifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materiale ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.Operatori është i obliguar që të kujdeset për drurideri në kultivim, në rastë deshtonë duhet të zëvendësojë atë me të ri.	copë	8.00	40.00 €	320.00
TOTALI 2 :					50,856.00
RIKAPITULLIM - VARREZAT DËSHMORËVE DHE MARTIRËVE NË RAHOVEC					
1	VARREZAT E DËSHMORËVE				23,370.00
2	VARREZAT E MARTIRËVE				50,856.00
TOTALI ME TVSH:					74,226.00



PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE TË DËSHMORËVE NE GRADISHË

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHIKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

VARREZAVE E DËSHMORËVE NE GRADISHË					
B	VARREZAT MARTIRËVE				
1	VARREZAT MARTIRËVE				
Poz.	PËRSHIKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Pastrimi i parcelles nga mbeturinat e mundshmedhe demelimin e shkurreve, materiali largohet ne deponi legale.	m ²	100.0	1.00 €	100.00
1.2	Demolimi, largimi i pllakave te betonit me dimensione 1x2m të cilat janë të vendosur mbi varre . Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri	copë	121.0	5.00 €	605.00
1.3	Gërmimi i dheut të kategorisë III -IV me trashësi t=30cm për pregatitjen e bazës së kubzave Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m ³	189.00	4.00 €	756.00
1.4	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm ne gjendje te ngjeshur.	m ³	105.00	7.00 €	735.00
1.5	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm ²	m ³	52.00	7.00 €	364.00
1.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubëzave të cilat realizohen në hapësirat ku do të ndërtohet shtigjet e ecjes Me dimensione 40x20 me trashësi t=6cm, Ngjyrë bardhë dhe zi e ndërthurur. Në çmim të kalkulohet shtresa e rërës fraksion 4 mm me trashësi t=6 cm dhe mbushja e fugave të kubëzave me rërë të imët.	m ²	525.00	25.00 €	13,125.00
1.7	Furnizimi dhe montimi i skajoreve 8x20x100 cm ne çmim te kalkulohet edhe betoni per shtangim nen skajor dhe mes fugave.	m'	640.00	8.00 €	5,120.00
1.8	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit në pjesët anësore me trashësi t=2cm. Në çmim te llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).(Vërejtje ngjyra e granitit duhet të jetë e njëjt me varrezat ekzistuese).	m ²	445	55.00	24,475.00
1.9	Furnizimi ,transporti dhe montimi i granitit për varreza me trashësi t=3cm. Pjesa e sipërme e varrit duhet të jetë komplet e mbuluar me granit dhe pjesët ansore duhet të jetë 3cm jashtë granitit anësor. Në çmim te llogaritet edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).(Vërejtje ngjyra e granitit duhet të jetë e njëjt me varrezat ekzistuese).	m ²	285	85.00	24,225.00
1.10	Furnizimi, transporti dhe montimi ulëseve nga konstruksioni metalik dhe mbështetëse.Me profile metali 6x2x180 cm me mbajtëse në të dy anët nga konstruksioni metalik. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid. Ulësja të punohet sipas detalit të prezantuar.	copë	2	250.00	500.00
1.11	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ-pisha e Alepit (Pinus halepensis"). Dru dekorativ arrin gjatesin deri ne 25m, rezistenc ndaj tokave jo shume pjellore, tolerant ndaj ndotjes urbane. Mbillet duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. Operatori është i obliguar që të kujdeset për drurideri në kultivim, në raste deshtonë duhet të zëvendësoj atë me të ri.	copë	40.00	40.00 €	1,600.00
1.12	Furnizimi transporti dhe montimi i shtizës metalike h=6m rrethore me dimensione D=141.3x5mm,. Shtyllat të inkastrohen me anë të bulonave M22mm me flaksha 40x40cm dhe trashësi 5mm,e cila vendoset në bazament prej betoni me dimensione 08x0.8x0.8m. Në çmim të llogaritet edhe mekanizmi për ngriçjen e flamurit, ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid dhe vendosja e flamurit me dimensione 1x2m.	copë	3.00	150.00 €	450.00



1.13	Furnizimi transporti dhe montimi i shtizës metalike h=12m rrethore me dimensione D=141.3x5mm,. Shtyllat të inkastrohen me anë të bulonave M22mm me flanka 50x50cm dhe trashësi 5mm,e cila vendoset në bazament prej betoni me dimensione 08x0.8x0.8m Në çmim të llogaritëd dhe mekanizmi për ngritjen e flamurit, ngjyrosja me bazë dhe ngjyrë antracid dhe vendosja e flamurit me dimensione 2x4m.	copë	1.00	200.00 €	200.00
1.14	Furnizimi, transporti dhe montimi i skeleve metalike. Skelet duhet të vendosen për rreth obiliskut me lartësi h=40m	m²	445	4.00	1,780.00
1.15	Largimi i kubëzave ekzistuese, dhe hapjen e kanlit për vendosjen e kabllos elektrike. Pas përfundimi të punimëve kubzat e njejet të rikthehen në gjendje të mëparshme, cdo dëmtim operatori është i obliguar që ta sanoj dhe ta rregullojë.	m'	30	5.00	150.00
1.16	Furnizimi dhe montimi i kabllosë energjetike NYY-J 3x1.5mm². dhe vendosja e shirit për paralajmërim "rrezik për jetë". Kabloja duhet të kyqet në rrejtin ekzistues.	m'	100	4.00	400.00
1.17	Furnizimi, transporti dhe montimi i kanalit të plastikës më përforcime kanali shërben për mbulimin e kabllos energjetike, kanali dhe kabloja duhet të montohet deri ne pikën më të lartë të obiliskut.	m'	60	4.00	240.00
1.18	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritës sinjalizuese në maje të obiliskut, drita duhet të inkastrohet mirë me bulona.	copë	1	150.00	150.00
1.19	Furnizimi dhe montimi, i siguresë nga poliesteri(aralgjite) per furnizimin e dritës ndricues.	copë	1	20.00	20.00
Muri me lartësi H=2.5m					
1.20	Gërmimi i dheut të kategoris IV-V per hapjen e shputës së themelit, Largimi i dheut të largohet në deponi ku e percakton organi mbikqyrës, jo me larg se 10km.	m³	8.00	5.00 €	40.00
1.21	Furnizimi,transporti dhe mbushja me zhavor 0-32, mbushja të realizohet në bazamentë me trashësi 10cm dhe pjesëve ansore të shputës së themelit.	m³	7.00	7.00 €	49.00
1.22	Furnizimi,transporti dhe punimi i murit nga B.A me lartësi h=2.5m gjërsi 25cm dhe gjatësi 6m, me shputë nga B.A me dimensione 0.6x1.2m. Në çmim të llogaritëd edhe pjesa e armimit.	m³	8.00	300.00 €	2,400.00
1.23	Furnizimi ,transporti dhe montimi i dy pllakave te granit me trashësi t=3cm me dimensione 120x200cm të vendosur në mënyr vertikale të përforcuar në murin e B.A. Ne pllakë duhet të bëhet gravimi i emrit, mbiemrit, viti i lindjes viti i rënjes dhe emblema e UÇK-së, brenda hapësirave të gravimi duhet të ngjyroset me ngjyrë të arit. Në çmim te llogaritëd edhe ngjitës sipas DIN/ EN 12004 (temperatura e aplikimit: +5°C deri 30°C).	m²	4.8	220.00	1,056.00
1.24	Furnizimi, transporti dhe montimi i gurëve natyral me trashësi t=3-5cm, me dimensione 15x7cm sipërfaqja e jashtme e gdhendur në mënyr natyrale pjesët ansore të prerë në form laserik. Vendosija e gurëve të realizohet në katë anet e murit, pjesa e sipërme e murit të vendosen rrasa guri të prerë në form laserike streha e gurit duhet të jete 3cm jashtë në të dy anët nga muri vertikal. Në çmim të llogaritëd ngjitësi dhe punimi i fugave.(Vërejtje Pjesa ku vendosen pllakat e Granitit nuk duhet të realizohet mveshja me gurë)	m²	35.00	65.00 €	2,275.00
TOTALI 1 :					80,815.00

REKAPITULIM I PËRGJITHSHËM		
1	VARREZAVE E DËSHMOREVE NE GRADISHË	80,815.0 €
TOTALI ME TVSH:		80,815.0 €



PARAMASA DHE PARALLOGARIA REVOVIMIN E KOMPLEKSIT MEMORIAL "KRUSHË E MADHË"

Kompleksi Memorial "Krushë e Madhe"

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETAJET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

REVOVIMI I KOMPLEKSIT MEMORIAL "KRUSHË E MADHË"					
1	PUNËT DEMOLUESE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Demolimi i afiteatrit te hapur ne pjesen te hyrja e kompleksit memorjal, transportimi i mbeturinave te ngurta deri ne depunin ne largesi L=10 km'.	m3	55.0	10.00 €	550.00
1.2	Demolimi i rrasave te gurit ne ter perimetrin e murit rrethues te kompleksit, ne pikoret e murit, rrasat jane me trashesi t=5 cm' dhe gjeresi b=25 cm'. Pjesa dermuese e rrasave duhet te demolohej me kujdes dhe duhet te ruhen ne kuader te kompleksit pasi qe te njetat duhet te vendosen perseri ne te njejtin pozicion.	m'	520.0	1.00 €	520.00
1.3	Demolimi i murit rrethues tek dalja e muzeut, muri eshte nga betoni me lartesi h1=1.0m' dhe h2=2.2m' dhe gjeresi h=20 cm', gjithashtu duhet te demolohej edhe pjesa e rrasave te gurit me trashesi t=5 cm', rrasat te cilat eshte muri i mveshur si dhe duhet te demolohej me kujdes sepse te njetat duhet te vendosen ne murin e ri qe o te punohet, si dhe demolimi i rrethojes se qelikut ne kuader te ketij muri gjithashtu rrethoja duhet te demolohej me kujdes sepse e njesta duhet te punohet ne murin rrethues te ri.	m'	9.0	10.00 €	90.00
1.4	Demolimi i ulseve nga materiali i drurit ne shkallet e afiteatrit, ulset jan ne for letfe me trashesi t=5cm' gjatesi L=80 cm' dhe gjeresi b=10 cm', i gjith materiali i demeluar ne kete pozicion duhet te ruhet ne vendin ku e cakton investitori.	m'	90.0	1.00 €	90.00
1.5	Demolimi i granitit te varrezave ne balloret e varrezave me dimensione 2.1m*0.35 cm dhe 1.0*0.35 cm dhe trashesi te mermerit t=3 cm' , varrezat te cilat jane te demtuara. Vërejtje: Pplaka e granitit te varrit e cila eshte ne pjesen e sipërme te varrit duhet te largohet me kujdes sepse e njeta duhet te vendoset perseri ne pozicionin e njete	copë	54.0	2.00 €	108.00
1.6	Kontrrollimi i rrjetit te ujitjes se hapsirave gjelbruese ne ter gjatesit e shperdarjes se rrjetit te gypave per ujitjen e hapsirave gjelbruese. Po ne kete pozicion duhet te perfshihet edhe sanimi nese haset ne defekte te rrjetit te ujitjes ndrrimin e gypit, ventilave etj. Deri ne funksionim te plot te rrjetit te ujitjes se hapsirave gjelbrues. Vërejtje : Sistemi i ujitjes eshte i teri nen tok me sistemin e pipave dales gjat leshimit te ujit per ujitje.	m'	450.0	0.50 €	225.00
1.7	Demolimi i suvas se mureve të amfiteatrit me shtresë rrafshuese, rezistuese ndaj gricave, temperaturave të larta, plasaritjeve dhe lagështisë. Suvatimi është i punuar me RENOFIX 20 llaç themelor nga çimento, rezistues ndaj ujit për mure me lagështi.	m²	90.0	1.00 €	90.00
1.8	Demontimi i shportave të mbeturinave, si dhe hudhja e tyre ne deponim e mbeturinave te ngurta ne largesi deri ne 10 Km'.	copë	17.0	1.00 €	17.00
TOTALI 1 :					1,690.00
2	PUNËT E GERMIMIT DHE MBUSHJËS				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2.1	Gërmimi i dheut per hapjen ethemelit te murit rrethues ne thellesi deri ne 40 cm' dhe gjeresi 40 cm'si dhe transportimi i dheut deri ne depuni ne largesi 10Km.	m³	5.0	10.00 €	50.00
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e zhavorit te sipërfaqes ku eshte demuuar pllatoja e Amfiteatrit me trashësi mesatare t= 30 cm, per pergatitjen e vendi per montimi i kubzave te betoni, ngjeshmeriaja duhet te jet 60 Mpa.	m2	55.0	2.00 €	110.00
2.3	Furnizimi , transportimi dhe montimi i kubzave te betonit me ngjeshje te kuqe me trashesi te kubzave t=8cm' dhe dimensione te kubzave 20*40 cm', ne qmim duhet te parashifet edhe rrera per nivelizim mbushja e fugave, si dhe tegjitha punet tjera percjellese per kete pozicion.	m3	55.0	20.00 €	1,100.00



2.4	Gërmimi I dheut për hapjen e kanalit për vendosjen e gypit për ujë të ftohtë dhe për hapjen e hapsirave gjelbrauese në atë pjesë ku nuk ka sistem të ujësjellësve të kanalit duhet të jetë h=50 cm'. Si dhe hudhja e dheut deri në deponi në largësi l=100m'. Në qmim duhet të parashifet edhe mbulimi i kanalit me dheun e germuar në pjesën e hapsirave gjelbrauese si dhe ngjeshja në shtresë e dheut të hudhur në kanal.	m3	15.0	5.00 €	75.00
2.5	Mbulimi i kanalit të hapësirës duhet të përshtrijet e gypit të ujësjellësve të mbulohet komplet me zhavor 0-60mm' si dhe ngjeshja në shtresë, në mënyrë që mos vijë deri të uja e asaj pjesë të kanalit në pjesën e pllato me kubza betoni.	m3	5.0	8.00 €	40.00
2.6	Demontimi i kubzave të betonit në pjesën ku duhet të hapet kanali, ruajtja e tyre si dhe pas përfundimit të mbulimit të kanalit të rivendosjen perseri kubzat e betonit siq kanë qene në gjendje të me parshme.	m2	50.0	4.00 €	200.00
2.7	Gërmimi I dheut për hapjen e kanalit për vendosjen e gypit nga burimi i fshatit në kodër deri të kompleksi memorial thellesia e kanalit duhet të jetë h=70 cm'. Si dhe hudhja e dheut deri në deponi në largësi l=100m'. Në qmim duhet të parashifet edhe mbulimi i kanalit me dheun e germuar në pjesën e hapsirave gjelbrauese si dhe ngjeshja në shtresë e dheut të hudhur në kanal.	m3	700.0	3.00 €	2,100.00
2.8	Furnizimi me zhavor për trajtim të gypit të ujë me një trashësi t=20 cm' në tërë gjatësinë e gypit, gypit duhet të trajtohet me zhavor min 10cm' si në tërë perimetrin e jashtëm të gypit.	m3	56.0	5.00 €	280.00
2.9	Demontimi i kubzave të betonit në pjesën ku duhet të hapet kanali, ruajtja e tyre si dhe pas përfundimit të mbulimit të kanalit të rivendosjen perseri kubzat e betonit siq kanë qene në gjendje të me parshme. Ky pozicion I bie në trotuarin për skaj murit rrethues të kompleksit Memorial.	m2	35.0	4.00 €	140.00
TOTALI 2 :					4,095.00
3	PUNËT E MEREMETIMIT-Muri rrethues I kompleksit,varret, pllaka memoriale.				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3.1	Montimi i rrasave të gurit me trashësi t=5 cm' në tërë perimetrin e murit rrethues me rrasat e demantuara me heret të cilat duhet të ngjiten me ngjites të qeramikes për ambjent të jashtëm, ngjites duhet të jetë I klasit të parë. Gjithashtu fugat në mes të rrasave duhet të mbushen me ngjites qeramike të klasit të parë për ambjent të jashtëm si dhe përpunimi i fugës që të mos jetë e vrazhd.	m'	500	3.00 €	1,500.00
3.2	Riparimi i pllakave të granitit të varreve, të cilat janë të demantuara me material special dhe ngjyrë të njëjtë si dhe polirimi në ato vende të demantuara të pllakave të sipërme të varreve.	cope	20	100.00 €	2,000.00
3.3	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të granitit White Carrara Granite në ansoret e varreve me dimension 210*35*3 cm' të cilat janë të demantuara, ngjyra dhe lloji i mermerit duhet të jetë I njëjtë me mermeret egzistues të varreve.	m2	40	85.00 €	3,400.00
3.4	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të granitit White Carrara Granite në ansoret e varreve me dimension 100*35*3 cm' të cilat janë të demantuara, ngjyra dhe lloji i mermerit duhet të jetë I njëjtë me mermeret egzistues të varreve.	m2	18	85.00 €	1,530.00
3.5	Përpunimi i shkrimeve mbi varre, si dhe ngjyrosja e tyre me të jetin model si egzistuesit, si dhe përpunimi i simbolit të shqiptarëve dhe skemës së UÇK-së ngjyrosja e tyre.	copë	156	2.00 €	312.00
3.6	Furnizimi , transportimi dhe montimi i pipave GARDEN futur për ujë të ftohtë dhe për ujë të ngrohtë për hapsirave gjelbrauese në tërë sipërfaqen e hapsirës së kompleksit Memorial, në qmim duhet të llogaritet se duhet të qmontohen pipat egzistues dhe të zevendesohen me pipa të rinj të me të gjitha pjesët përcjellëse, pipat janë nga materiali PVC me sistem ngritës prej presionit të ujë. Verejtje: Pipat janë dy lloje dhe të njëjtë duhet të vendosen pa pasur ndryshime.	copë	115	3.00 €	345.00
3.7	Furnizimi , transportimi dhe montimi i kutisë së bashku me aparatoren për programim të leshimit të ujë për ujë, aparatoren duhet të jenë edhe digjitale dhe mekanike, në qmim duhet të parashifet që të punohet edhe kutija prej inoksi për vendosjen e kësaj aparature si dhe rrjeti i rrymës për kyqjen e kutisë si dhe të gjitha punët tjera përcjellëse.	copë	2	250.00 €	500.00

3.8	Furnizimi , transportimi dhe montimi I pipave per te fontana ku duhet te heken pipat egzistues dhe te vendosen te rrije pipat duhet te jen nga inoxi rezistues ndaj korezionit.	copë	15	10.00 €	150.00
3.9	Furnizimi dhe mveshja e fontanës me gurë graniti sipas projektit. Graniti do jetë i kualitetit të lartë ku pjesa tjetër do mveshët me ngjyrë të bardhë White Carrara Granite, Absolute White Granite ose ngjashëm, me trashësi 3.0 cm. Graniti duhet te jetë i klasit te parë	m2	26	85.00 €	2,210.00
3.10	Furnizimi me material dhe montimi I profileve te qelikut 40*20*2.5 mm' ne form harkore ne pjesen e tribues se afitecatrit per montimi e ulseve nga druri, profilat duhet te montohen ne form harkore te afitecatrit ne dy rende ne drejtimin gjatsor ndersa ne drejtimi terthor ne gdjo 1m' per perforceimin e profilat gjatsor ndersa profili terthor duhet te ankerohet ne beton me bulona. Profilet duhet te ngjyrosen ne dys shtre ngjyr kunder korozionit dhe ne dy shtrese ngjyr te zez. Ne qmim duhet te parashifen edhe bulonat per ankerim se bashku me tiplat e betonit per ankerim l=8cm'min.	m'	95	20.00 €	1,900.00
3.11	Furnizimi me material dhe montimi ulseve nga druri (drasave) I klasit te par dhe me lageshti max 12% , ne drejtimin terthor te tribunave. Dimesnioni e pjeseve te drasave per ulse duhet te jene ne form trapezi gjeresia duhet te jet ne njeran ane 10 cm ndersa skaji tjetër 15 cm trashesi t=5 cm' ndersa gjatesia l=80 cm'. Druri duhet te jete ne tri ane i struguar dhe duhet te lyhet dy here me llak pa ngjyr kunder lageshtis dhe dy shtresa llak yndyror me ngjyr kafe. Zbrzetira ne mes duhet te jet 5 cm' larg njera tjetres. Ulset duhet te shlangohen me nga dy bulona Ø 10mm'.	copë	10	30.00 €	300.00
3.12	Furnizimi dhe suvatimi i mureve të amfitecatrit me shtresë rrafshuese, rezistuese ndaj gricave, temperaturave të larta, plasaritjeve dhe lagështisë. Suvatimi të bëhet me RENOFIX 20 llag themelor nga çimento, rezistues ndaj ujit për mure me lagështi. Ky llojë llag përdoret për mure të jashtme dhe të brendshme. Përdoret mbi të gjitha llojet e bazamentit normal, mbi beton të vrazhdë, suvatues për shahte, mure mbrojtëse, bodrume etj. Të punohet sipas standardeve të prodhuesit RENOVA.	m²	80	8.00 €	640.00
3.13	Furnizimi dhe vëndosja e shportave të mbeturinave në pikat e caktuara, siç janë paraparë në projekt. Modeli I tyre do jetë I përshkruar në përshkrimin teknik.	copë	20	70.00 €	1,400.00
3.14	Perpunimi I shkrimeve tek pllaka perkujtimore, si dhe ngjyrosja e tyre me te jetin model si egzistuesit, si dhe perpunimi I simbolit te shqiponjes dhe skemes se UÇK-së ngjyrosja e tyre.	copë	150	2.00 €	300.00
3.15	Furnizimi me material dhe montimi I pllakave te granitit White Carrara Granite ne pjesën e sipërme tek lapidari dhe pllaka perkujtimore' te cilat jane te demtuara, ngjyra dhe lloi I mermerit duhet te jete I njet me mermeret egzistues qe jane te vendosura tek pllaka perkujtimore.	m2	20	150.00 €	3,000.00
3.16	Furnizimi me material dhe montimi I pllakave te granitit White Carrara Granite ne ansoret tek lapidari dhe pllaka perkujtimore' te cilat jane te demtuara, ngjyra dhe lloi I mermerit duhet te jete I njet me mermeret egzistues qe jane te vendosura tek pllaka perkujtimore.	m2	15	85.00 €	1,275.00
3.17	Furnizimi, tansportimi dhe montimi I profilave nga alumin me dimensione 40*20 mm', te cilet duhet te shtangohen ne nje lartesi prej 20 cm' tek pllaka memoriale per vendosejn e luleve dhe kurorave, profilat duhet te perforceohen ne shtyllat e pllakes se memorjane dhe duhet te vendosen ne meny horizontale dhe duhet te jen 20 cm' larg pllakes memoriale dhe nje hapsir ne mes dy profilave duhet te jet prej 8 cm' ne meny qe ne mes te vedosen buqetat me luele.	m'	10	40.00 €	400.00
TOTALI 3 :					21,162.00
4	HIDROINSTALIMET				
Poz.	PËRSHIKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
4.1	Germimi i dheut te kategoris III-IV.	m	40	5.00 €	200.00
4.2	Furnizimi me rëre dhe mbulimi nen gyp per rreth gypit dhe mbi	m	5	8.00 €	40.00
4.3	Furnizimi dhe instalimi i gypave Ø 63.	m	650	4.00 €	2,600.00

4.2	Furnizimi, punimi i kaptazhes tek burimi i ujit ne koder te fshatit, kapatazha duhet te punohet ne menyre qe uji i burimit te dirdhet ne gypin e vendosur Ø 63. Ne qmim duhen te parashifen te gjitha punet perezjellse ne kete pozicion, pra deri ne funksionimin e plot te thithjes se ujit.	copë	1	200.00 €	200.00
5.2	Furnizimi dhe instalimi i gypave Ø 16.	m	100	2.00 €	200.00
4.4	Furnizimi dhe instalimi i "T" lidhseve T 32-16-32.	Copë	5	5.00 €	25.00
4.3	Furnizimi dhe instalimi i gjysëm lidhse Ø 32.	Copë	12	5.00 €	60.00
6.2	Punimi i kapakut te pusetes kontrolluese 1.5x1.5. Kapaku duhet te jete nag materiali i PVC me pesh bartese deri ne 4t.	Copë	1	100.00 €	100.00
4.5	Elemente të paparashikuara.	Komplet	1	100.00 €	100.00
				TOTALI 4 :	3,525.00

REKAPITULIM I PËRGJITHSHËM		
1	PUNËT DEMOLUESE	1,690.00
2	PUNËT E GERMIMIT DHE MBUSHJËS	4,095.00
3	PUNËT E MEREMETIMIT-Muri rrethues i kompleksit,varret, pllaka memoriale.	21,162.00
4	IIIDROINSTALIMET	3,525.00
TOTALI ME TVSH:		30,472.00



PARAMASA DHE PARALLOGRIA PËR RREGULLIMIN E VARREZAVE TË DËSHMORËVE NË FSHATIN NAGAVC

Pjesë përbërëse e paramasës janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

D	RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE NË FSHATIN NAGAVC				
1	PUNËT NDËRTIMORE				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi I pllakave të dëshmorëve nga graniti me trashesi t=3cm ngjyrë e zezë me dimensione 60x80cm. E gravruar emri, shkronja e parë e prindrit, mbiemri, dt. e lindjës, dt e rënjës, foto e dëshmorit dhe emblema e UÇK-së. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja e shkronjave me bazë dhe ngjyrë të bronzët.	copë	2.00	300.00 €	600.00
1.2	Furnizimi, transporti dhe montimi I pllakave të dëshmorëve nga graniti me trashesi t=3cm ngjyrë e zezë me dimensione 40x60cm. E gravruar emri, shkronja e parë e prindrit, mbiemri, dt. e lindjës, dt e rënjës dhe emblema e UÇK-së. Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosja e shkronjave me bazë dhe ngjyrë të bronzët.	copë	5.00	250.00 €	1,250.00
TOTALI 1:					1,850.00
	RIKAPITULLIM I PËRGJITHSHËM				
1	RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE NË FSHATIN NAGAVC				1,850.00
	TOTALI ME TVSH:				1,850.00



PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR RENOVIMIN E SHTABIT NË DRENOC

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.

E	RENOVIMI I SHTABIT NË DRENOC				
	ARKITEKTURA				
1	PUNËT DEMOLIMIT				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Demolimi I dyervev të jashtme ekzistuese nga metali. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	7.00	5.0 €	35.00
1.2	Demolimi I dyervev të brendshme ekzistuese nga druri. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	4.00	5.0 €	20.00
1.3	Demolimi I dritareve ekzistuese nga metali. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	11.00	5.0 €	55.00
1.4	Demolimi I dritareve ekzistuese nga druri. Largimin I mbeturinave inerte te behet ne vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	copë	3.00	5.0 €	15.00
1.5	Demolimi i komplet I dyshemesë me te gjitha shtresat: pllakat qeramika, estrihu, termoizolimi ne tere siperfaqen e baze së përdhësës dhe katit. Demolimi te realizohet deri në pllakën e betonit. Siperfaqja demoluse te llogaritet ne m ²	m ²	394.00	0.30 €	118.20
1.6	Demolimi (grryerja) e suvatimit ne te gjitha muret dhe pllafonet e brendshme te objektit. Demolimi te realizohet ne hapsirat te cilalet behen instalimet e ndryshme. Siperfaqja demoluse te llogaritet ne m2. Në çmim te llogariten edhe demolimi i instalimeve të ndryshme të improvizuara dhe të shtuara mbi dhe nën sipërfaqet e mureve(prizat,kabllo, ndërprerës, lampat, etj.).	m ²	920.00	1.00 €	920.00
1.7	Gërryerja dhe pastrimi i komplet sipërfaqes së jashtme të objektit. Demolimi te realizohet ne hapsirat te cilat behen instalimet e ndryshme. Siperfaqja demoluse te llogaritet ne m2. Në çmim te llogariten edhe demolimi i instalimeve të ndryshme të improvizuara dhe të shtuara mbi dhe nën sipërfaqet e mureve(prizat,kabllo, ndërprerës, lampat, etj.).	m ²	394.00	1.0 €	394.00
1.8	Demolimi i komplet konstruksionit të kulmit me të gjitha shtresat deri në pllakën B.A. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i ullukëve vertikal dhe horizontal të objektit. Largimi i mbeturinave inerte të bëhet në vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	m ²	250.00	2 €	500.00
1.9	Demolimi i shtreses se betonit rreth objektit me gjersi 80 cm. Siperfaqja demoluse te llogaritet ne m ²	m ²	40.00	1.00 €	40.00
1.10	Demolimi i murit dhe rrethojës ekzistues në pjesen e përparme të objektit. Largimi i mbeturinave inerte të bëhet në vendin ku e përcakton organi mbiqkyrës jo me larg se 5km.	m ²	40.00	1.00 €	40.00
1.11	Prerja precize e pllakës së betonit për hapjen e vrimave ne secilin katë, dhe ne secilen pjese ku parashihet vendosja e vertikaleve te kanalizimit me dimensionet 25x25 cm .	m ²	0.20	100.00 €	20.00
1.12	Demontimi dhe rivendosja e betonit ku kalon gypi i kanalizimit fekal. Ne çmim të llogaritet komplet vendosja betonit pas vendosjes, izolimit dhe testimit të gypit të kanalizimit fekal.	m ³	7.00	5.00 €	35.00
1.13	Furnizimi me material dhe vendosja e skeleve për të gjithë hapësirën e objektit, si dhe vendosja e rrjetës mbrojtëse. Njëashtu, të demolohen të gjitha pengesat të cilat pengojnë në vendosjen e skeleve. Vërejtje: Siguria të jetë maksimale.	m ²	394.00	2.0 €	788.00

1.14	Pas përfundimit të punimeve duhet të largohen të gjitha skelet dhe të bëhet pastrimi i objektit si dhe terreni përreth objektit. Gjatë punimeve të punohet me kujdes maksimal dhe të gjitha kabllo të instalimeve elektrike të mos dëntohen.	copë	1.00	50.00 €	50.00
TOTAL: 1					3,030.20
2	PUNËT E DYSHEMESË				
Poz.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2.1	Furnizimi dhe vendosja e pvc folis e cila duhet te vendoset mbi shtresn termoizoluese per punimin e estrihut.	m²	370.00	2.00 €	740.00
2.2	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses se estrihut ne pllaken e dyshemes se perdheses, katit I dhe katit II me makinë me trashësi 5-7cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese striporit t=4cm dhe shtreses hidroizoluese.	m²	370.00	9.00 €	3,330.00
2.3	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses mbrojtese (estrih) me makinë me trashësi 4-5 cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese nen konstruksionin e kulmit	m²	370.00	7.00 €	2,590.00
